

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi për ish-krerët e UÇK-së/ Dritan Goxhaj nga protesta: UÇK-ja nuk ishte një grup kriminal, por për gjigje e një populli që po shfarosej
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/vendimi-per-ish-kreret-e-uk-se-dritan-goxhaj-nga-protesta-uk-ja-nuk-i-i514509
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 18:04:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 17:59:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	aeb19cc2972534cf02c23c0219412be268a76c8fafc5d72cfecb1d9a013f4209
TEKSTI	fcc08d294bfc1bd73460f9eca7edb620cdd50e81f266156b25d13b3353a20736
PAMJA	9ec1c148fdbbb04888f137fa714c56ea93f0a2eb797f95ed18fcdd743f618569

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2ebd04ed5a2d17474e53a0082842364d2e8264fbf444dc524fd559b445dcae56
E MËPARSHMJA	4bdad7ad51f97172d8c4bc6e111e4d84198e3c3baa16e03e433728a897ec6712
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2ebd04ed5a2d17474e53a0082842364d2e8264fbf444dc524fd559b445dcae56>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

54 MINUTA ME PARE

Dita e 109-të e protestës kundër Ramës, qytetarët rikthehen në shesh, paralajmërojnë marshim drejt Parlamentit

8 ORE ME PARE

Haga dënoi Kosovën/ Tensione dhe përplasje jashtë Gjykatës Speciale, familjarët e ish-krerëve të UÇK-së: E papranueshme, do e apelojmë

11 ORE ME PARE

Gjykata Speciale ridënon Kosovën. Bie akuza për krime kundër njerëzimit, po dënimet jepen maksimale. Thaçi & Krasniqi 25 vite burg, 18 Veseli dhe 13 Selimi

22 ORE ME PARE

SYTË NGA HAGA/ Nesër shpallet vendimi për ish-krerët e UÇK-së, rrugët mbushen me flamuj e mbishkrime për Thaçin, Veselin, Krasniqin e Selimin: Shpallini të pafajshëm (PAMJET)

Aktualitet

Vendimi për ish-krerët e UÇK-së/ Dritan Goxhaj nga protesta: UÇK-ja nuk ishte një grup kriminal, por përgjigje e një populli që po shfarosej

UÇK-ja, sipas Goxhaj nuk ishte një grup kriminal apo një lëvizje terroriste por ishte përgjigja e një populli që po shfarosej kundër shtetit serb që thoshte "Kosova është Serbi"



16 Shtator 2026, 19:59
Nga G.M



Dritan Goxhaj, ish-luftëtar i UÇK-së

TIRANË- Protesta në Tiranë ka shënuar ditën e 109-të të revoltës qytetare kundër qeverisë. Në protestën e sotme nuk kanë munguar as reagimet nga protestuesit në lidhje me vendimin e Gjykatës së Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

Pjesë e protestës ka qënë edhe ish-luftëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Dritan Goxhaj, i cili ka marrë fjalën në podium dhe e ka cilësuar vendimin si të padrejtë dhe të bazuar në dëshmi të rreme, dhe me procedura që nuk kanë asnjë lidhje me të vërtetën.

Ai është shprehur në fjalën e tij se një gjykatë e cila bazohet në dëshmi të manipuluar dhe nuk ka transparencë, nuk ka kontroll. UÇK-ja, sipas Goxhaj nuk ishte një grup kriminal apo një lëvizje terroriste por ishte përgjigja e një populli që po shfarosej kundër shtetit serb që thoshte "Kosova është Serbi"

Dritan Goxhaj: *Sot dua të lexoj një deklaratë në emër të grupit koordinues. Sot, një ditë e zezë për luftën e popullit për liri. Sot, Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë dhanë dënime të rënda për katër ish-pjesëtarët e UÇK-së.*

Sot, ne nuk po flasim për drejtësi, po flasim për padrejtësi, për një gjykatë që nuk ka asgjë të përbashkët me asnjë gjykatë tjetër në botë. Po flasim për një vendim të bazuar në dëshmi të rreme, mbi procedura të panjohura dhe mbi një axhendë politike që nuk ka asnjë lidhje me të vërtetën.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 16 SHTATOR 2026, 16:18

81 vite burg për katër ish-krerët e UÇK-së/ Nga kërkesat ndërkombëtare te vota e Kuvendit/ Si u ngrit Gjykata Speciale në Hagë? Rama me helikopter drejt Prishtinës për të kërkuar votat pro

POLITIKE 16 SHTATOR 2026, 12:46

DOKUMENTI/ Publikohet vendimi i plotë i dënimit të ish-krerëve të UÇK-së

Ne jemi të qartë, kjo nuk është drejtësi, është teatër. Një gjykatë politike që bazohet mbi dëshmi të rreme, të paprovuara, të manipuluar, që nuk ka juri, nuk ka transparencë, nuk ka kontroll. Një gjykatë politike që dënon njerëz që kanë luftuar për lirinë e popullit të tyre.

Kjo nuk është drejtësi, kjo është padrejtësi e organizuar. Kjo padrejtësi po vjen nga Evropa, e ngritur mbi parimet e të drejtave të njeriut, drejtësisë dhe lirisë. Evropa për të cilën kemi ëndërruar dhe shtrirë dorën për ndihmë, bashkëpunim dhe integrim. Vjen nga Evropa, nga ana që pretendon se janë miq tanë.

Kjo padrejtësi po ndodh nga ajo Evropë që në vitin 1913 vendosi të na copëtojë Shqipërinë, Kosovën ia dha Serbisë pa pyetur shqiptarët, pa pyetur askënd, vetëm për të bërë paqe në Ballkan. Stabiliteti nuk mund të përdoret më si pretekst duke sakrifikuar të drejtën e shqiptarëve për të vetëvendosur dhe për të jetuar të lirë.

UÇK-ja nuk ishte një grup kriminal, nuk ishte një ushtri e huaj, nuk ishte një lëvizje terroriste. UÇK-ja ishte përgjigjja e një populli që po shfarosej kundër shtetit serb, që vriste në rrugë, digjte shtëpi, përdhunonte gra, dëbonte fëmijë dhe thoshte: "Kosova është Serbi"./Dosja.al

uçk dritan goxhaj protesta ne tirane

Sondazh

Poll

Aktualitet

16 Shtator 2026, 19:48

RTSH hap sezonin e ri: Identitet i ri vizual dhe pesë seriale superprodhime

Imazh i ri, progrmacion me personazhe të rinj dhe një paketëik me pesë seriale që janë superprodhime me tematika nga romanca tek...



Të shtënat me armë në Durrës/ I plagosur mbeti një avokat, policia në kërkim të autorit (EMRAT+PAMJET)

Aktualitet

16 Shtator 2026, 19:19

Protesta në Tiranë/ Nis marshimi drejt godinës së Kryeministritsë

Aktualitet

16 Shtator 2026, 19:13

AKTUALITET 16 SHTATOR 2026, 12:40

"Vendimi i Gjykatës Speciale në Hagë u prit në lot nga qytetarët"/ Reuters: Vendimi u ndoq nga afër edhe Serbi

më të klikuarat

Përgjimet dhe akuzat për tregti armësh, reagon kompania ku u përgjuan: Ron Yeffet nuk na përfaqëson, përgjimi ishte i paautorizuar

VIDEO/ Biznesmeni Samir Mane paraqitet në Prokurorinë e Posaçme

Tensione para Dhomave të Specializuara në Hagë/ Protestuesit përplasen me policinë holandeze: Largohuni ose do përdorim forcën (VIDEO)

81 vite burg për katër ish-krerët e UÇK-së/ Nga kërkesat ndërkombëtare te vota e Kuvendit/ Si u ngrit Gjykata Speciale në Hagë? Rama me helikopter drejt Prishtinës për të kërkuar votat pro

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow.

Dita e 109-të e protestës/ Nis organizimi i protestuesve në sheshin Skënderbej

Aktualitet

16 Shtator 2026, 19:04

Arrestohet kushëriri i Ergys Agasit/ Eno Agasi zhduku verën miliona euro nga kantina djalit të xhaxhait

Aktualitet

16 Shtator 2026, 18:59

Aktualitet

16 Shtator 2026, 18:33

VIDEO/ Biznesmeni Samir Mane paraqitet në Prokurorinë e Posaçme

Samir Mane TIRANË- Biznesmeni Samir Mane është paraqitur pasditen e kësaj të mërkure në Prokurorinë e Posaçme...

Protesta në Hagë pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së, arrestohen dy persona dhe lëndohet një polic

Aktualitet

16 Shtator 2026, 18:15

Plagosje me armë zjarri në Durrës

Aktualitet


16 Shtator 2026, 17:50

Shisnin kokainë në një lokal, në pranga tre persona në Elbasan

Vendimi për ish-krerët e UÇK-së/ Protestuesit qëllonjë me gurë në drejtim të ndërtesës së Qeverisë në Prishtinë (VIDEO)

Aktualitet
16 Shtator 2026, 16:25

MË SHUMË



Të shtënë me armë në Durrës/ I plagosur mbeti një
avokat, policia në kërkim të autorit

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE



Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MEZDORRËSHIAR NGA Mediaset

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.